



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

**të mbledhjes së gjashtë të Komitetit për Politikës dhe Financa, mbajtur më
26.09.2018, duke filluar në orën 10:00.**

**Në mbledhje morën pjesë: Agim Kuleta, kryesues i Komitetit, anëtarët e Komitetit:
Genc Sherifi, Vala Peshku, Halim Halimi, Agim Gashi, Jeta Rafuna, Sami Boroci,
Blerand Stavileci, Eman Rrahmani, Fadil Gashi dhe Egzon Azemi.**

**Në mbledhje morën pjesë edhe: Osman Bllaca, përfaqësues i ekzekutivit, Fatos Dibra,
përfaqësues i Zyrës ligjore, Valbona Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave,
Valbona Osmani - Mehmetaj, drejtoreshë e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, Fatime
Hajdari, drejtoreshë e Drejtorisë së Parqeve dhe Mentor Zeka, përfaqësues nga OSBE-
ja.**

**Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Agim Kuleta, kryesues.
Njëzëri u miratua ky**

REND I DITËS:

- 1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së pestë të Komitetit për Politikë dhe Financa;**
- 2. Propozimvendimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2019 dhe Kornizës afatmesme buxhetore për periudhën 2019-2021(KAB);**
- 3. Propozimvendimi për rritje të mjeteve të të hyrave vetanake 2017 dhe për bartje të mjeteve nga viti 2017 në vitin 2018;**
- 4. Të ndryshme.**

Agim Kuleta, kryesues, hapi diskutimin lidhur me rendin e ditës.

Halim Halimi bëri vërejtje se materiali nuk po dërgohet ashtu siç është e paraparë me ligj, 7 ditë pune para mbajtjes së mbledhjes, si për Komitet për Politikë dhe Financa ashtu edhe për Kuvend.

Ai tha se kemi kërkuar dhe ka qenë zotim i Kryetarit dhe obligim, që për këtë mbledhje me qenë në rend dite edhe Raporti i auditimit.

Agim Gashi tha se dihet afati kohor dhe relacioni Komitet – Kuvend. Se sa duhet të jetë diferenca, kjo rregullohet me ligj, andaj kërkoj sqarim nga Zyra ligjore se a korrespondon kjo me ligjin, nëse jo, atëherë ne po bëjmë shkelje ligjore dhe shkelje administrativo-juridike.

Agim Kuleta, kryesues, dha sqarime, duke cekur se janë konsultuar me Ministrinë e Pushtetit Lokal dhe në bazë të diskutimeve që kanë pasur, kuptohet se nuk është e ndaluar me pasur 2 ditë diferencë mes Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit, pasi që ka qenë situata për miratimin e buxhetin brenda muajit shtator. Për këtë kemi kërkuar zyrtarisht interpretim prej Ministrisë dhe interpretimi i tyre është që mund të mbahet 2 ditë pas KPF-së edhe Kuvendi.

Agim Gashi pyeti se Ministria interpretimin ligjor e bënë sipas momentit, apo bazohen në ligjet që e rregullojnë këto fushë!

Agim Kuleta, kryesues, dha sqarime, duke cekur se nuk është e precizuar se mbas KPF-së me qenë 7 ditë pune, thotë 7 ditë pune prej momentit të thirrjes së mbledhjes. Sipas MAPL-së, nuk është në kundërshtim me ligjin dhe autoriteti i MAPL-së është më i madh se ne.

Fatos Dibra dha sqarime, duke cekur se ligji është, e rregullon me Udhëzimin administrativ për Kuvend dhe për KPF. Është e qartë, thuhet se Komiteti thirret 7 ditë pune përpara se mu mbajtur, me udhëzim për Kuvend thuhet 7 ditë pune para se me u mbajtur Kuvendi, e përcakton se a duhet 7 dite të jetë pas mbledhjes së Komitetit, mirëpo nuk e përcakton kurë fillon afati. Në këtë rast, kur ligji është i paqartë, ne kemi kontaktuar me MAPL-në, sepse nuk e përcakton qartë ligji. Sipas MAPL-së, është në rregull, së paku 2 ditë të jetë diferenca e KPF-së dhe Kuvendit.

Agim Gashi theksoi se ligjërisht dhe proceduralisht materiali dërgohet së pari në Komitet, se është trupë obliguese, që të shqyrtohet në Komitet, pastaj caktohet afati ligjor për thirrje të Kuvendit.

Sami Boroci kërkoi që të mos bëhet shprehi kjo formë. Ai rekomandoi që oraret e mbajtjes së mbledhjeve të jenë në fund të muajit, Komiteti rreth datës 20, e Kuvendi pas 7 ditësh, kështu që për neve kishte me qenë më lehtë me ditur, sepse jemi të angazhuar në sektorë të tjerë dhe duhet ta planifikojmë kohën për pjesëmarrje në këto mbledhje.

Eman Rrahmani theksoi se materiali për buxhet, i cili ka ardhur në KPF, i njëjti me ardhur edhe në Kuvend për mua është e papranueshme. Materiali u dërgohet asamblastëve për Kuvend dy ditë para se të mbahet seanca dhe me shikuar, me analizuar buxhetin për vitin 2019 është diçka absurde. Ne është dashur të njoftohemi më herët se ka me qenë buxheti në muajin e ardhshëm, me u përgatitur dhe me ardhur me propozime.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbaleve të mbledhjes së pestë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së pestë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pika e dytë

Propozimvendimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2019 dhe Kornizës afatmesme buxhetore për periudhën 2019-2021 (KAB).

Valbona Makolli i informoi asamblistët se gjatë periudhës korrik – gusht, janë mbajtur 6 takime publike. Kërkesat dhe propozimet e reja që kanë qenë, i kemi shqyrtuar me drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe atë të Shërbimeve Publike, i kemi paraqitur shumicën e propozimeve, por edhe projektet që na kanë mbetur janë vazhduar.

Ajo informoi edhe lidhur me një problem, duke thënë se Ministria e Financave dje ka lajmëruar se Ligji për Prishtinën duhet të përfshihet në buxhetin aktual. Që nga dje, Kryetari ka qenë në bisedime me ministrin Bedri Hamza, sepse nuk janë pajtuar në disa pika, d.m.th në shpërndarje e jo në shumë, sepse shumica është votuar, por në shpërndarjen e këtyre 5 pikave nuk kanë qenë të pajtimit. Mospajtimi ka qenë te kategoria e pagave dhe mëditjeve, sepse sipas Ligjit për Prishtinën është paraparë edhe policia e kryeqytetit, e nëse bëhet policia e kryeqytetit, atëherë duhet siguruar edhe pagat për ta. Ministria e Financave e ka kundërshtuar këtë vendim të Kryetarit, ndërsa kategoritë e tjera i kanë shpërndarë. Komplet buxheti shtesë është 10. 841.400 € vetëm për Ligjin e Prishtinës, është grant qeveritar që iu ka ndarë për këtë vit Komunës së Prishtinës dhe kjo shumë është kërkuar nga ne, që deri më 30.09.2018 me qenë e shpërndarë në buxhetin total.

Agim Gashi tha se kjo është tema më e rëndësishme. Në planin e punës së Kuvendit nuk ka pikë të rendit të ditës më të rëndësishme se shqyrtimi dhe miratimi i buxhetit. Neve na mungojnë informacionet shtesë, për të nxjerrë dhe miratuar një buxhet sa më mirë të planifikuar.

Ai pyeti se nga janë siguruar burimet prej 67 milionë € pa buxhetin për Ligjin e Prishtinës. Ne si këshilltarë duhet t'i dimë, t'i kemi disa të dhëna krahasimtare për një periudhë të caktuar, që të mund të votojmë për diçka që ju e keni planifikuar dhe mendoni se e keni mirë. Dallimi në mes të vitit të kaluar dhe vitit të ardhshëm, është diku 15-16 milionë, për 2 vjet nuk rritet buxheti për 15 - 16 milionë.

Valbona Makolli dha përgjigje, duke cekur se burimi i buxhetit të përgjithshëm është nga niveli qendror. Sa i përket shtesave, përveç 1.8, nuk ka shtesë tjetër, siç tha parafolësi 15-16 milionë, vjet kanë qenë 72 milionë €, e sivjet janë 76,892,425.00 €.



Sa i përket tatimit në tokë, ne nuk kemi platformë. Ministria e Financave na ka thënë se ligji hyn në fuqi, jemi duke punuar, prej secilës komunë është nga një përfaqësues, është duke u punuar në Ligjin për tatimin në tokë dhe disa të meta që i ka pasur tatimi në pronë.

Agim Gashi ceku edhe taksat te mbeturinat, parkingjet, te hapësirat publike, te burimet e tjera, aty kemi ngecje të madhe, vetëm i keni fryrë, nuk jeni bazuar në mundësitë reale të realizimit.

Valbona Makolli theksoi se në fillim ka pasur ngecje te taksat e mbeturinave. Tani arkëtimi është në rritje e sipër, por ende nuk është i kënaqshëm.

Eman Rrahmani kërkoi nga drejtoresha që të bëhet një analizë më e mirë dhe një shpërndarje më e mirë.

Valbona Makolli tha se sipas Ministrisë së Financave, e kemi një tavan dhe të gjitha investimet kapitale në arsim, shëndetësi, kulturë etj. shkojnë përmes të njëjtit drejtor.

Eman Rrahmani pyeti se me çfarë mjete paguhen kontratat e vitit 2016, kur dihet se bartja nuk bëhet.

Valbona Makolli dha sqarime lidhur me këtë pyetje.

Agim Gashi tha se ne po kërkojmë të dimë pse nuk është ardhur për 9 muaj propozimi për bartjen e buxhetit dhe tregoni sa mjete janë shpenzuar nga 14 milionëshi pa u bartur buxheti. Kuvendi është i autorizuar për bartje të buxhetit, ju i keni shpenzuar mjetet pa vendim të Kuvendit dhe nuk e dimë a i keni shpenzuar mirë apo keq.

Agim Kuleta, kryesues hodhi në votim **Propozimvendimin për miratimin e buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2019 dhe Kornizës afatmesme buxhetore për periudhën 2019-2021(KAB)**.

Kryesuesi konstatoi se më 6 vota për, 3 vota kundër dhe 1 abstenim, u miratua **Propozimvendimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2019 dhe Kornizës afatmesme buxhetore për periudhën 2019-2021(KAB)** dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e tretë

Propozimvendimi për rritje të mjeteve të të hyrave vetanake 2017 dhe për bartje të mjeteve nga viti 2017 në vitin 2018.

Valbona Makolli dha sqarime lidhur me këtë pikë, duke thënë se rritja e të hyrave vetanake, të cekura në nenin e 2 të këtij propozimvendimi, është në shumën prej 134.243,20 €, ku Ministria e Financave e ka konstatuar si tejkalim të të hyrave vetanake të Komunës së Prishtinës dhe ka kërkuar të bëhet bartja e mjeteve, siç janë këto projekte të cilat janë bartur sipas prioriteteve të Kryetarit dhe janë ato projekte që janë mbetur, zakonisht janë 3-vjeçare, që kanë mbetur, ose janë projekte që janë lidhur muajt e fundit: tetor, nëntor dhe dhjetor të vitit 2017.

Eman Rrahmani pyeti se cili projekt ka filluar në fund të vitit 2017.

Valbona Makolli dha sqarime lidhur me këtë pyetje.

Agim Gashi tha se sa i përket specifikimit, lidhur me këto projekte këtu duhet të flasë përfaqësuesi i drejtorisë së Infrastrukturës, t'i zbërthejë ato nëse ka pyetje, se ai është

kompetent për atë dhe i dinë fazat e projekteve. Po ashtu, tha se secili drejtor do të duhej të ishte këtu, që të shpjegojë arsyeshmërinë e shpërndarjes së buxhetit.

Fadil Gashi pyeti se a janë të obliguar drejtorët e drejtorive me qenë të pranishëm në mbledhje të Komitetit për Politikë e Financa, në bazë të ligjit.

Agim Kuleta, kryesues, tha se nuk e kanë obligim ligjor, por për të funksionuar më mirë është dashur të jenë të pranishëm.

Agim Kuleta, kryesues, hodhi në votim Propozimvendimin për rritje të mjeteve të të hyrave vetanake 2017 dhe për bartje të mjeteve nga viti 2017 në vitin 2018.

Kryesuesi konstatoi se më 6 vota për, 5 vota kundër, u miratua Propozimvendimi për rritje të mjeteve të të hyrave vetanake 2017 dhe për bartje të mjeteve nga viti 2017 në vitin 2018, dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Të ndryshme

Eman Rrahmani tha se në mbledhjen e fundit që e kemi mbajtur, jemi pajtuar që në rend dite për këtë mbledhje me qenë edhe Raporti i ndërmarrjeve publike.

Agim Kuleta, kryesues, tha se për këtë mbledhje jemi përqendruar vetëm te buxheti, por sot ose nesër ju vjen ftesa për mbledhjen e radhës të KPF-së dhe besoj se do të jetë si pikë e rendit të ditës.

Sami Boroci tha se ka kaluar 1 vit i qeverisjes dhe nuk kemi mundur me i konsoliduar shumë prej ndërmarrjeve publike, andaj besoj se ka vend për trajtim në Kuvend. Janë shumë pak NP që e kanë konsoliduar bordin dhe kanë zgjedhur shefin. Unë e përkrah një iniciativë të tillë dhe duhet diskutuar për këtë.

Agim Gashi pyeti se a do të jenë për mbledhjen e radhës edhe dy materiale që nuk i sollët në këtë seancë, siç janë: Raporti 6-mujor financiar dhe Raporti i auditimit.

Mbledhja përfundoi në orën 11:00.

Procesmbajtësja
Shyhrete Islami



Kryesuesi i Komitetit
Agim Kuleta